

PROTOKOLL

Lidhur ndërmjet

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ZYRA E KOORDINATORIT NACIONAL KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ

DHE

SEKRETARIATIT TË PËRGJITHSHËM TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
MALIT TË ZI
ZYRA PËR LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ

PËR

BASHKPUNIM NË LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës - Zyra e Koordinatorit Nacional kundër trafikimit me njerëz dhe Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Malit të Zi - Zyra për luftimin e trafikimit me njerëz (në tekstin e mëtuqeshëm: Palët),

Me qëllim përmirësimin e identifikimit, lajmërimit, referimit, bashkpunimin në qështjet penale dhe për kthimin vullnetar të asistuar të viktimave dhe atyre të mundshme të trafikimit me njerëz,

Palët dakordohen si në vijim:

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Me këtë Protokoll në mënyrë të veçantë rregullohen çështjet të cilat kanë të bëjnë me identifikimin e viktimave dhe atyre potenciale të trafikimit me njerëz dhe personat e shfrytëzuar për punë të detyruar, posaçërisht gjatë sezonit ndërtimorë dhe turistik.
2. Dispozitat e këtij Protokollit zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejt, përveç në rastet kur në të është përkufizuar ndryshe.

Neni 2 QËLLIMI

Protokollit ka për synim forcimin e bashkëpunimit në mes të organeve kompetente, palëve nënshkruese dhe organeve tjera shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, në:

1. Luftimin e punës së detyruar gjatë sezonit turistik, sidomos dukurisë së lypsarëve të lëmshës;
2. Intensifikimin e këmbimit të informacioneve dhe bashkëpunimit në mes policisë, prokurorisë, inspektoratit të punës, qendrave për punë sociale dhe strukturave të tjera relevante, si dhe ndihmë në identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave dhe atyre potenciale të trafikimit me njerëz, përfshirë dhe bashkëpunimin në procedura fillestare penale dhe atyre penale kundër trafikuesve të njerëzve të cilët veprojnë në të dy shtetet;
3. Forcimin e bashkëpunimit në mes të Zyreve të Koordinatorëve Nacional për luftimin e trafikimit me njerëz në të dy shtetet;
4. Realizimin e fushatave të përbashkëta për ndërgjegjësimin e publikut mbi problemin e kërkim-lëmshës së detyruar.
5. Forcimin e bashkëpunimit në zbatimin e Protokollit dhe akteve të tjera ndërkombëtare, si: Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, Protokollit për preventivë, luftimin dhe dënimin e trafikimit me qenie njerëzore, sidomos me femra dhe fëmijë, Konventa e Këshillit të Evropës në luftimin e trafikimit me njerëz, Konventën mbi të drejtat e fëmijëve dhe Protokollit Fakultativ mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionit të tyre dhe pornografisë, si dhe akteve të tjera ndërkombëtare që merren me këtë çështje;
6. Zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta në mënyre që të gjindet një kundërpërgjigje kualitative për trendet aktuale kur është në pyetje trafikimi me njerëz.
7. Implementimin e projekteve të përbashkëta të bashkëpunimit ndërkufitar në fushën e luftimit të trafikimit me njerëz e që do të financohen mundësisht nga fondet IPA-së.

II FUSHA E ZBATIMIT

Neni 3

Fusha dhe organet kompetente për përcjellje dhe zbatim të këtij Protokollit

1. Ky Protokoll aplikohet për çdo formë të trafikimit me njerëz pavarësisht nga ajo se a përmban në vete elemente të krimit të organizuar.
2. Organet kompetente për përcjelljen e zbatimit të këtij Protokollit janë:

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës:

- *MPB - Zyra e Koordinatorit Nacional kundër Trafikimit me Njerëz*

Për Qeverinë e Republikës së Malit të Zi:

- *SGjQ - Zyra për Luftimin e Trafikimit me Njerëz*

3. Organet e ngarkuara për zbatimin e këtij Protokollit janë: ministritë e punëve të brendshme-drejtoria e policisë, prokuroria, drejtoria e inspektoratit për mbikëqyrje, ministria e punës dhe mirëqenies sociale të të dy shteteve si dhe OJQ-të të cilat merren me mbrojtjen e viktimave të trafikimit me njerëz.

Neni 4

Fusha dhe mënyra e bashkëpunimit

Organet kompetente për përcjelljen e zbatimit të këtij Protokollit obligohen që:

1. Të bëhet këmbimi i informacioneve me qëllim të parandalimit, zbulimi, procesimi i veprave penale e që kanë të bëjnë me trafikim të njerëzve më së paku dy herë në vit, gjersa këmbimi i informacioneve operative në mes shërbimeve kompetente të dy shteteve do të bëhet sipas nevojës, e në raste emergjente nëpërmes personave kontaktues:

1.1. Informata mbi identifikimin e rasteve përmban të gjitha shënimet e nevojshme për një hetimit profesional të suksesshëm si dhe identifikimi, udhëzimi dhe ofrimi i mbrojtjes sa më kualitative, në pajtim me interesin më të mirë të viktimës/ viktimës potenciale të trafikimit me njerëz;

1.2. Organet kompetente për përcjelljen e zbatimit të këtij Protokollit do të hartojnë formularin për këmbimin e informacioneve, që do të jetë në Shtojcën 1 të këtij Protokollit.

1.3. Këmbimi i informacioneve nga paragrafi 1 i këtij neni nuk do të kufizohet vetëm në rastet e trafikimit me njerëz por do të vlejë edhe në rastet për fëmijët të cilët kërkojnë lëmoshë në rrugë dhe eksploatimi i femrave në situatat të cilat paraqesin rrezik nga trafikimi me njerëz;

2. Të bëhet analiza e informacioneve nga Neni 5, paragrafi 1 të këtij Protokollit.

3. Të organizohen takimet në nivelin qendror çdo gjashtë muaj; të planifikohen takimet dhe sipas nevojës të organizohen takime lokale për zgjidhjen emergjente të çështjeve operative, rasteve të veçanta ose problemeve që kanë të bëjnë me trafikim të njerëzve me qëllim të identifikimit, njoftimit, referimit, bashkëpunimit në hetimet ndëshkimore dhe kthimin e ndihmuar të viktimave dhe viktimave potenciale të trafikimit me njerëz.

4. Të koordinohet zbatimi i këtij Protokollit nga ana e organeve të policisë, prokurorisë, shërbimeve sociale dhe organeve të tjera, varësisht nga nevoja e rastit të identifikuar, gjithmonë në pajtim me Marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet policive dhe prokurorive të të dy shteteve për bashkpunim në qështjet e krimit të organizuar dhe konventat ndërkombëtare në fuqi që rregullojnë këtë fushë.

5. Të organizohen aktivitete të përbashkëta me qëllim të pengimit të dukurisë së lypsarëve për lëmoshë, më theks të veçantë në iniciimin e fushatave të përbashkëta për ngritjen e vetëdijes së publikut.

6. Të sigurohet bashkëpunimi në mes prokurorëve, policisë, inspektorëve të punës dhe strukturave tjera relevante të të dy shteteve në luftimin e prostitucionit dhe kontrabandimin me njerëz.

7. Të bëhet shkëmbimi i përvojave dhe të organizohen trajnime, punëtori dhe seminare për polici, prokurorë, inspektorë të punës dhe përfaqësues të qendrave për punë sociale;

8. Të aplikohet me programe të bashkëpunimit ndërkufitar në fushën e luftimit e trafikimit me njerëz tek fondet e IPA-së.

9. Në bashkëpunim të udhëheqësve të organeve përgjegjëse për zbatim të Protokollit, të emërohen kontakt-personat të cilët do të përcjellin zbatimin e Protokollit sipas mënyrave të përcaktuara në Nenin 5 të këtij Protokollit.

10. Organet përgjegjëse për zbatimin e këtij Protokollit, kujdes të veçantë do ti kushtojnë:

10.1. Kërkesave të viktimave dhe viktimave potenciale të trafikimit me njerëz, për informim, udhëzim, mbrojtje dhe ndihmë për kthim vullnetar në shtetin e prejardhjes;

10.2. Shëndetit, moshës dhe nevojave të tyre për mbrojtje; të drejtave të tyre në pajtim me instrumentet përkatëse ndërkombëtare gjatë periudhës së reflektimit, qëndrimit, të shpërnguljes së përkohshme apo të përhershme si dhe nevojave të bashkëpunimit gjithëpërfshirës me qëllim të hetimit sa më të shpejte të rasteve të tilla.

III

AKTIVITETET KRYESORE TË IDENTIFIKIMIT, REFERIMIT, MBROJTJES DHE KTHIMIT TË NDIHMUAR VULLNETAR TË VIKTIMAVE/ VIKTIMAVE POTENCIALE TË TRAFIKIMIT ME NJERËZ

Neni 5

Identifikimi dhe referimi i viktimave/viktima potenciale të trafikimit me njerëz

1. Organet e ngarkuara për zbatimin e këtij Protokollit marrin përsipër identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave potenciale të trafikimit me njerëz sipas standardeve të parashikuara me legjisllacionin e tyre të brendshëm;

2. Procesi i identifikimit do të zhvillohet në bazë të sistemit formal dhe mekanizmit të identifikimit të viktimave/viktimave potenciale të trafikimit me njerëz të paraparë me legjisllacionin e brendshëm të palëve;

3. Për rastet kur fëmijët janë viktimave/viktima potenciale të trafikimit me njerëz, palët e këtij Protokollit do të zbatojnë veprimet efektive për identifikimin e tyre sa më të shpejt. Policia, shërbimet sociale, shërbimet shëndetësore, institucionet arsimore, qeverisja

lokale, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare ose akterë të tjerë menjëherë po sa të marrin vesh për raste të tilla do të lajmërojnë organet përkatëse të shteteve të tyre të cilët do të vazhdojnë me masat e nevojshme për mbrojtjen e viktimave duke përfshirë dhe lajmërimi i organeve kompetente për përcjelljen e zbatimit të këtij Protokollit të palës tjetër;

4. Për sa është e mundur palët do të harmonizojnë procedurat e tyre të identifikimit dhe raportimit të viktimave/viktimave potenciale të trafikimit me njerëz përherë duke pasur në qendër të vëmendjes interesin e viktimës;

5. Për të gjitha rastet e identifikuar, organet kompetente për përcjelljen e zbatimit të këtij Protokollit do të formojnë dosje të veçantë për secilin person të identifikuar si viktimë/viktimë potenciale e trafikimit me njerëz. Organet e ngarkuara për zbatimin e këtij Protokollit të cilat kryejnë identifikimin fillestar të rastit, caktojnë menaxherin e rastit. Në bashkëpunim me organe të tjera, menaxheri i rastit bën analizën e rrezikut dhe vlerëson nevojat e rastit si dhe harton planin e veprimit për asistimin e rastit.

Neni 6 Njoftimi Paraprak

1. Palët nënshkruese të këtij Protokollit pajtohen se do ta njoftojnë njëra tjetrën për të gjitha rastet e identifikuar të viktimave/viktimave potenciale të trafikimit me njerëz kur ato janë shtetas të palës tjetër – nënshkruese të këtij Protokollit;

2. Njoftimi paraprak do të bëhet menjëherë pas identifikimit të viktimës/viktimës potenciale të trafikimit me njerëz nga ana e organeve kompetente, kurse më së voni 7 ditë nga momenti i identifikimit të viktimës/viktimës potenciale të trafikimit me njerëz;

3. Për rastet e identifikuar kur viktimë/viktima potenciale e trafikimit me njerëz është fëmijë, lajmërimi duhet të dërgohet menjëherë me qëllim të informimit të prindërve ose kujdestarit ligjor të fëmijut; fëmiju për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se është viktime e trafikimit me njerëz kthehet në shtetin e prejardhjes menjëherë pas marrjes së pëlqimit të prindit të fëmijut apo kujdestarit ligjor të tij; nëse në veprimet e hetuesisë në afat prej 30 ditëve nuk grumbullohen dëshmitë për dyshimin e bazuar së fjala është për fëmijun që është viktimë e trafikimit me njerëz, fëmiju urgjentisht kthehet në shtetin e prejardhjes.¹

4. Pas njoftimit paraprak shteti i prejardhjes ndërmerr të gjitha masat për vlerësimin e rrezikut dhe sigurimin e kushteve për kthim vullnetar dhe ndihmë viktimës, përveç në rastet kur viktimë/viktima potenciale e trafikimit me njerëz, fëmiju – i mituri, për të cilin

¹ Konventa mbi të drejtat e fëmijut, garanton fëmijut jetes me prinder te vet, ne familjen e vet biologjike. Kjo e drejte mund ti kufizohet femiut vetem me vendim te organit kompetent shteteror dhe ate me qellim te realizimit te interesit me te mire te femiut. Shtetet nenshkruese te Konventes kane ndermarr obligim qe te ofrojne mbrojte per femije deri ne mundesit te veta te skajshme, bile deri ne kerkim te ndihmes nderkombetare per mbrojte te femiut. Kjo do te thote qe shteti duhet te permbushe te gjitha te drejtat e garantuara me Konventen mbi te drejtat e femiut.